



# AKTIVITETET KRYESORE TË ADMINISTRATËS DOGANORE SHQIPTARE

## I Shtator 2022 I

### Dogana në shifra

Performanca e të ardhurave doganore-Shtator 2022  
Shtator 2022, 3.8 mld lekë më shumë se Shtator 2021  
7.5 % realizimi planit nga doganat Shtator 2022

Në muajin Shtator 2022 realizimi i të ardhurave doganore është në masën 20,6 mld lekë, një shumë rekord krahasuar me çdo Shtator prej vitit 2013. Krahasuar me Shtator 2021 janë realizuar +3,8 mld lekë më shumë ose rreth +22,5%. Krahasuar me planin janë realizuar rreth +2 mld lekë ose +7,5%.  
Mallrat e akcizës kanë patur realizim pozitiv: cigarja +27 ton, birra +200 mijë litra

20,6mld  
lekë

Të ardhura nga dogana për shtatorin, rekord historik krahasuar me çdo Shtator prej vitit 2013

+3,8mld  
lekë

Më shumë arkëtime doganore krahasuar me shtatorin 2021. Rritja e konsumit të produkteve të akcizës është faktori kryesor

## ËKONOMIA NË FOKUS

### EKSPORTET

e mallrave Janar - Gusht 2022

arritën vlerën 35 mld lekë,  
duke u rritur me 48,1%,  
në krahasim me të njëjtën  
periudhë të një viti më parë.



### IMPORTET

e mallrave Janar - Gusht 2022

arritën vlerën 80 mld lekë,  
duke u rritur me 30,8%,  
në krahasim me të njëjtën  
periudhë të një viti më parë.



### Dogana online

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave i është bashkuar nismës së Qeverisë për të dixhitalizuar shërbimet online për qytetarët dhe bizneset nëpërmjet platformës E- albania . Digjitalizimi i sistemit doganor ka bërë që të krijohen lehtësi për biznesin, shkurtim të kohës procedurale, rritje e transparencës dhe ulje e nivelit të korrupsionit.  
Këto shërbime kanë krijuar lehtësira për biznesin dhe qytetarët nëpërmjet ofrimit të shërbimit në kohë dhe me cilësi, duke shmangur vonesat dhe burokracitë e panevojshme.  
Vetëm gjatë muajit Gusht nga DPD janë miratuar 656 shërbime online, ndërkohë që janë në proces 67 aplikime të tjera.



### Shërbejmë me profesionalizëm

Bashkimi Evropian dhe GIZ mbështesin Administratën Doganore dhe AKU për lehtësimin e tregtisë me vendet e rajonit  
Drejtor i Përgjithshëm i Doganave z. Genti Gazheli mori pjesë në takim rajonal mbi "Fuqizimin e bashkëpunimit ndërmjet Administratave Doganore dhe Agjencive përgjegjëse për sektorin Fitosanitar në kuadrin e programit OEA", mbajtur në Vlorë, me datë 21 shtator 2022.  
Takimi rajonal u organizua në kuadër të projektit "Mbështetje për Integrimin Ekonomik Rajonal", i zbatuar nga Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH dhe i mbështetur nga Komisioni Evropian dhe Ministria Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (BMZ).  
Në fjalën e tij z. Gazheli u shpreh se numri i konsiderueshëm i aplikimeve të shoqërive shqiptare për programin OEA është tregues i një interesi në rritje të eksportuesve dhe importuesve për gjithë përfitimet e programit OEA.



### VLERËSIMI DOGANOR I HIDROKARBUREVE

Legjislacioni Doganor (Kodi Doganor, Dispozitat Zbatuese të tij) si dhe specifikisht Udhëzimi i Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 3 datë 23.01.2018, përcaktojnë qartë procedurat dhe metodologjinë e vlerësimit të mallrave për qëllime doganore.

Një nga mënyrat e vlerësimit doganor të mallrave është dhe metoda bazuar në "Dosjen e të Dhënave të Disponueshme" ku përfshihen edhe përditësimet e hidrokarbureve.



Burim për përditësimin e produkteve hidrokarbure, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave përdor të dhënat ditore (ditë pune) përmbyllëse, të publikuara nga një prej agjencive ndërkombëtare më me

reputacion "S & P Global Platts", me qendër në Londër, me të cilën kjo drejtori bashkëpunon prej 15 vitesh. Theksojmë faktin se Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për artikujt si:  
benzinë, gazoil, mazut, solar, vajgur, jet, gaz i lëngshëm (butan, propan), biodiesel shfrytëzon të dhënat përmbyllëse ditore të S&P Global Platts.  
Me këto të dhëna informohen çdo ditë strukturat doganore.

